# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441756**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | ‘E zhdukur’ prej tri ditësh/ Zbulohen detaje tronditëse për fatin e foshnjës 11-muajshe në Turqi: I ati e shit i në këmbim të parave |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/13/e-zhdukur-prej-tri-ditesh-zbulohen-detaje-tronditese-per-fatin-e-foshnjes-11-muajshe-ne-turqi-i-ati-e-shiti-ne-kembim-te-parave/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 20:58:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 20:50:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 20:49:00 UTC → 13 shtator 2026, 20:51:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a32059f09e9f3666fcee086b8b7b9237c3664d8d54384974d6a52079cf451a9c` |
| TEKSTI | `3b97eea21c676e0835b1c7d479616a5a1a1c51ca88f908fdc3a3a31e1b6c583d` |
| PAMJA | `1c8c75abd81ed277c8614f4a66ff7c48708f8daa0f57b667d9b2eb17acafa715` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `17456a4b39c16fe4930707b56ee8a5d804f9f5003ad141f86e7df51452afa45a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5a17c12c14e78c5a4225635ca4dd5bf0de00406a8b7800bc862a616c14968175` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/17456a4b39c16fe4930707b56ee8a5d804f9f5003ad141f86e7df51452afa45a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE LAJME TË FUNDIT

# ‘E zhdukur’ prej tri ditësh/ Zbulohen detaje tronditëse për fatin e foshnjës 11-muajshe në Turqi: I ati e shiti në këmbim të parave

13/09/2026 22:50




**Një zhvillim tronditës ka ndodhur në rastin e zhdukjes së një foshnje 11-muajshe në Turqi, e cila prej tre ditësh ishte shpallur e zhdukur dhe kishte shkaktuar një operacion të gjerë kërkimi.**

Arrestimi i prindërve dhe katër personave të tjerë ka ngritur dyshime të forta se foshnja mund të jetë shitur.

Në lagjen Divriği të provincës së Sivasit, nëna e foshnjës, Elif Balıkçı, 27 vjeç, babai i saj, YB, si dhe katër persona të tjerë, janë marrë në paraburgim.

Gjatë dëshmisë së saj, nëna ka deklaruar se foshnja iu dorëzua personave të tretë nga babai i saj, në këmbim të parave, ndërsa pretendimi për zhdukjen e saj ishte i rremë.

Ngjarja është raportuar më 10 shtator, në fshatin Gündüren, në provincën e Divriğit.

Elif Balıkçı, e cila kishte ardhur nga Dijarbakiri si punëtore sezonale dhe merrej me blegtori, telefonoi Qendrën e Emergjencës 112 dhe raportoi se nuk po e gjente vajzën e saj, Busra, në tendën ku jetonin.

Pas telefonatës, në zonë u dërguan ekipet e AFAD-it dhe xhandarmërisë, të cilat nisën një operacion të gjerë kërkimi për gjetjen e foshnjës.

Në operacion morën pjesë ekipet e AFAD-it, komandot dhe forcat e xhandarmërisë. Për kërkimet u përdorën gjithashtu dronë me inteligjencë artificiale dhe qen të trajnuar për zbulim.

Në dëshminë e saj, Elif Balıkçı deklaroi se natën e 10 shtatorit, ndërsa vajza e saj Busra flinte në tendë, në zonë mbërriti një makinë e bardhë.

Sipas saj, njëri prej dy personave që zbritën nga automjeti hyri në tendë, mori foshnjën dhe u largua.

Megjithatë, nëna deklaroi se foshnja ishte dorëzuar më herët tek këta persona nga babai i saj, YB, në këmbim të parave.

Ajo pretendoi gjithashtu se katër persona që jetonin në zonën e tendave kishin qenë dëshmitarë të ngjarjes dhe se historia e “zhdukjes” ishte sajuar.

Gjashtë të arrestuarit pritet të paraqiten në gjykatë të hënën, ndërsa hetimet vijojnë për të zbardhur rrethanat e ngjarjes dhe për të përcaktuar vendndodhjen e foshnjës.

**Top Channel**

## Kryesore



“Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë”/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar
19:18

“Dil jashtë”/ Debati me Ramën gjatë dëgjesës për ‘Territorialen’ në Berat, Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin: Doja të flisja, ai u çua i irrituar dhe...
20:00

“Një nga mendjet më të ndritura që kishim”/ Nga Grida Duma te Spartak Ngjela dhe Rajmonda Bulku, miqtë kujtojnë Artur Zhejin në ‘Exclusive’
21:58

E rëndë në Padova, dhëndri mbyt me qese vjehrrën 97-vjeçare, dyshohet se...
18:57

Renditja/ Elbasani i bën “nder” Teutës, durrsakët kryesojnë të vetëm, Vllaznia në krizë të thellë. Si paraqitet situata në Superiore pas javës së katërt
20:39

## Më të lexuarat

“Dil jashtë”/ Debati me Ramën gjatë dëgjesës për ‘Territorialen’ në Berat, Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin: Doja të flisja, ai u çua i irrituar dhe...

Takimi i Ramës në Berat për Territorialen/ Debate në sallë mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe Egla Cenos

Rama paralajmëron hapjen e 4 universiteteve të reja në vend, kryeministri zbulon qytetet që do të mirëpresin institucionet arsimore

Video/ 27-vjeçarja ndërmerr aktin ekstrem, hidhet nga kati i 15 i pallatit, bie sipër karrocës me fëmijë

“300 mijë eurot vendosi te depozita e gazit”/ Zbulohen detaje nga ngjarja e rëndë në Vorë, 56-vjeçari i la kushëririt plumbin në zarf në derën e shtëpisë

Takimi në Berat për hartën e re territoriale, Rama: Kokëfortësia kolektive e Poliçanit dhe këmbëngulja e disa zonjave të Dimalit i dhanë...

Zbulohet pse “Çunat e Londrës” po stepen në të investuarin në Shqipëri, Daily Mail gjurmon pronat e konfiskuara

**Protestat anti-emigracion në Britani ndryshojnë taktikat, analiza e BBC: Maskime, kamionë dhe bllokime rrugësh**
12/09 12:56

**Detajet/ Arratisja e të burgosurit shqiptar në Greqi, gjendet mes shkurreve një automjet i aksidentuar, dyshohet se u përdor nga bashkëpunëtorët**
12/09 11:22

**Ambasada e Kroacisë në Shqipëri takim me të rinjtë e qytetit: Ndërtojnë një të ardhme të përbashkët evropiane**
11/09 22:07

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



**Top Channel/ Trump sfidon ekspertët: Alarmet për Inteligjencën Artificiale janë të ekzagjeruara**



**Top News- Viti i Ri Hebre, kryerabinj Yoel Kaplan: Shqipëria të vazhdojë të jetë mikpritëse**



**Top Channel/ Mitsotakis sfidon Erdoganin: Zotërojmë të drejtën e zgjerimit me 12 milje**



**Top Channel/Pagat,Rama gozhdon gjyqtarin:E pabesueshme si e sheh buxhetin e shtetit si "qesen e vet"**



**Top News- Zjarr pranë stallave të lopëve në Valare, zjarrfikësit parandalojnë përhapjen e flakëve**




**Lajmet kryesore të ditës – Top News, 13 Shtator 2026**



© Top Channel 2001 - 2026 · Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.